


shkurt 2018

gap | analizë



**EFEKTET E LIGJIT
PËR FALJEN E BORXHEVE**

EFEKTET E LIGJIT PËR FALJEN E BORXHEVE

Përmbledhje ekzekutive

Ligji për faljen e borxheve hyri në fuqi me 3 shtator 2015 dhe ka qenë në fuqi për dy vite. Ky ligj mundësoi faljen e borxheve që kishin qytetarët dhe bizneset ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike deri më 31 dhjetor 2008. Kusht për përfitim nga falja e borxhit ishte pagesa e plotë apo lidhja e kontratave dy dhe tri vjeçare për persona fizikë dhe juridikë për pagesën e borxheve të akumuluar nga 1 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014.

Para Kosovës, politika për faljen e borxheve kishin vendosur edhe Kroacia (2015) dhe Maqedonia (2014). Por, për dallim nga Kosova, këto dy shtete kishin synuar shtresat e shoqërisë më në nevojë dhe nuk kushtëzuan pagesa të borxhit.

Procesi i faljes së borxheve në Kosovë nuk ka qenë transparent dhe nuk është raportuar saktë. Komisioni për mbikëqyrjen e faljes së borxheve në Ministrinë e Financave nuk ka arritur të sigurojë raporte nga të gjitha ndërmarrjet publike dhe institucionet shtetërore dhe të dhënat për faljen e borxheve nuk kanë qenë të qasshme për publikun. Sipas raportit të këtij komisioni, shuma totale e borxhit për falje deri në fund të vitit 2008 arriti në 568 milionë euro, e që është për rreth 100 milionë euro më pak se sa shifra e prezantuar nga ish Ministri i Financave në vitin 2015 në kuvend. Po ashtu, sipas të dhënave që kemi pranuar nga ndërmarrjet publike dhe institucionet

shtetërore, borxhi total ndaj tyre deri në fund të vitit 2008 ishte 584 milionë euro.

Sa i përket suksesit të ligjit për faljen e borxheve, duke u bazuar në të dhënat që Instituti GAP ka mundur t'i mbledhë, janë falur rreth 56% të borxheve që i takojnë periudhës deri në fund të vitit 2008. Ndërkaq për periudhën 2009-2014, janë shlyer rreth 30% të borxheve të identifikuar nga Instituti GAP.

Sipas të dhënave të siguruara nga anketimi i institucioneve dhe ndërmarrjeve publike, borxhi më i madh i akumuluar deri në fund të vitit 2008 ishte ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) me 48% dhe ndaj ndërmarrjeve publike, ku afro 70% e këtij borxhi ishte ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Për shumicën e borxheve të kësaj periudhe, afati ligjor për ngritjen e padive ndaj konsumatorëve nga ndërmarrjet publike dhe institucionet shtetërore kishte kaluar meqë ky afat është 12 muaj për persona fizikë dhe 36 muaj për persona juridikë, respektivisht, sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 që ishte në fuqi deri në vitin 2011.

Me Ligjin për faljen e borxheve, qeveria shpresonte të stimulojë konsumatorët për pagesa të rregullta të detyrimeve ndaj shtetit në vitet që pasojnë. Për vitet 2015 dhe 2016, disa institucione dhe ndërmarrje publike kanë parë rritje në arkëtim. Duke u bazuar vetëm në sektorin e ujërave kemi parë një efekt pozitiv në shkallën e arkëtitimit të këtyre ndërmarrjeve publike, mirëpo për shumicën e institucioneve borxhi i akumuluar mbetet i lartë.

Megjithatë, ligji është pritur mirë nga qytetarët, ku mbi 77% e të anketuarve e kanë vlerësuar faljen e borxheve si të drejtë, ndërsa vetëm 8% e kanë cilësuar atë si të padrejtë. Shumica e atyre që e kanë konsideruar të padrejtë nuk kanë përfituar nga falja e borxheve duke lënë të nënkuptohet se konsumatorët që kanë paguar faturat me rregull janë dekurajuar nga kjo iniciativë.

Sipas institucioneve dhe ndërmarrjeve të anketuara, ligji në fjalë e ka arritur qëllimin vetëm pjesërisht dhe kjo kryesisht për shkak të gjendjes së dobët ekonomike të qytetarëve dhe mungesës së efikasitetit të gjyqësorit. Por, efekti gjysmak vlerësohet të jetë edhe për shkak të mos dërgimit me kohë të lëndëve në gjykata nga institucionet shtetërore.

Hyrje

Falja e borxheve nënkupton faljen e pjeshme ose të plotë të borxheve të individëve, kompanive, apo shteteve ndaj kreditorëve siç janë bankat, institucionet shtetërore, ndërmarrjet publike apo private. Në Kosovë, Ligji për faljen e borxhit publik ka hyrë në fuqi në shtator 2015 si rrjedhojë e problemeve në arkëtimin e obligimeve të konsumatorëve dhe për shkak të kushteve të rënda socio-ekonomike. Qëllimi i kësaj analize është që të bëjë një vlerësim nëse Ligji për faljen e borxheve ka arritur objektivën e tij lidhur

me faljen e borxheve dhe efektet që ka pasur në inkasimin e borxhit nga institucionet publike. Gjithashtu, duke i klasifikuar qytetarët në bazë të të ardhurave familjare, kjo analizë identifikon kategorinë e qytetarëve që kanë përfutur nga Ligji për faljen e borxheve.

Shuma e borxhit që qytetarët dhe bizneset kishin ndaj institucioneve të përfshira në këtë ligj deri në fund të vitit 2014 ishte rreth 900 milionë euro. Para se ky ligj të hyjë në fuqi, në gusht të vitit 2015, Instituti GAP kishte analizuar¹ efektet e mundëshme të tij, strukturën e borxheve dhe pengesat që mund të dalin në zbatimin e plotë të këtij ligji. Si përfundim, Instituti GAP kishte ardhur në përfundim se ligji për faljen e borxheve më shumë i ngjan një lehtësimi administrativ për institucionet se sa faljes ligjore të borxheve, meqenëse borxhet ishin parashkruar apo vjetërsuar dhe për to nuk mund të ngritej padi.

Falja e borxheve kishte për qëllim të ofronte lehtësira për konsumatorët e të gjitha kategorive, qoftë amvisëri, biznese apo subjekte tjera, por në fakt zbuloi se disa nga institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet publike nuk kishin mbajtur regjistër të detajuar të borxhlinjve dhe kryesisht nuk i kanë ndjekur penalisht borxhlinjtë e vegjël, të cilët njëkohësisht e kanë krijuar shumicën e borxhit që falej me ligjin e lartpërmendur. Për shkak të kostos që paraqet përgatitja e lëndëve për gjykata ndaj konsumatorëve të vegjël dhe procedurave të stërzgjatura në gjykata, u pamundësua mbledhja e borxheve dhe ngritja e rasteve gjyqësore për borxhlinjtë. Si rezultat i kësaj, edhe para se të kompletohej legjislacioni për faljen e borxheve, shumica e borxhit që do të falej tanimë veç ishte i humbur.²

Metodologjia

Për të analizuar rezultatet e faljes së borxheve, Instituti GAP ka realizuar intervista preliminare dhe ka dërguar pyetësorë tek Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, si dhe 22 ndërmarrje publike, prej të cilave vetëm dhjetë janë përgjigjur. Të dhënat e ofruara përmes pyetësorëve në disa raste tregojnë për mungesë të klasifikimit të të dhënave nga këto institucione sipas kategorive të ndryshme të konsumatorëve, siç mund të shihet në aneks.

Anketa me qytetarë është bërë duke përdorur metodën sasiore të hulumtimeve. Anketa është bërë në 38 komuna të Kosovës me 1,065 qytetarë të moshës mbi 18 vjeç – 818 shqiptarë, 150 serbë dhe 97 pjesëtarë të komuniteteve të tjera. Për përcaktimin e mostrës në këtë anketim është përdorur teknika e “mostrës së shtresuar të rastit”, ku popullata e

¹ Instituti GAP (2015) “Kush do të përfitojë nga falja e borxheve?” Burimi: <http://bit.ly/1KGBUOY>

² Ibid.

përgjithshme është ndarë në grupe më të vogla që njihen si shtresa, bazuar në karakteristikat e përbashkëta të pjesëtarëve të këtyre shtresave. Për secilin komunë është bërë shtrirja e mostrës në pjesët urbane dhe rurale, sipas statistikave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Shtresimi i tretë është bërë në bazë të numrit të anketave të realizuara në secilin vendbanim (pikë startuese). Pikat startuese në këtë hulumtim janë përcaktuar sipas metodës së rastësisë. Hulumtimi në terren është zhvilluar nga UBO Consulting nga data 14 deri më 25 dhjetor 2017. Ky hulumtim ka nivel të besueshmërisë prej 95% me marzhë të gabimit +/-3%.

Shembuj të faljes së borxheve publike

Falja e borxheve nuk është praktikë e re. Gjatë tri dekadave të fundit, mënyra më e njohur e faljes së borxheve është ajo ndërkombëtare ku bankat ndërkombëtare për zhvillim apo institucionet tjera financiare ua falin borxhin shteteve të varfëra dhe atyre në zhvillim për t'ua ulur barrën financiare dhe për të mos iu penguar në zhvillim. Kjo rrodhi nga iniciativa e vitit 1996 e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore për lehtësimin e barrës së borxhit të vendeve të varfëra me borxhe të mëdha (HIPC).³

Falja e borxhit publik të brendshëm në shumicën e vendeve të zhvilluara e merr formën e faljes së kredive të studentëve të cilat zakonisht duhet të paguhen përgjatë tërë jetës apo përmes ndonjë programi me bankat komerciale. Falja e borxheve kombëtare ndaj institucioneve shtetërore vërehet më shumë në shtetet e pazhvilluara, ato në zhvillim apo në tranzicion, sikurse në rastin e Kosovës.

Politika të ngjashme për faljen e borxheve ishin vendosur edhe në vendet e rajonit. Në vitin 2015, Kroacia mori masa për të falur borxhin për kategoritë më të varfëra të shoqërisë për të siguruar një "fillim të ri" për borxhlinjtë dhe për ta ndihmuar ekonominë.⁴ Për dallim nga Kosova, Kroacia synoi qytetarët më në nevojë, specifikisht familjet që kanë të hyra mujore jo më të mëdha se 350 euro, nuk kanë kursime apo prona dhe kanë borxhe deri në 4,800 euro.⁵ Qeveria kroate vlerësonte se mund të ishin 60,000 raste të cilët mund të përfitonin nga falja e borxheve. Sipas një kumtese të qeverisë kroate, në total ishin 37,000 kërkesa për shlyerjen e borxheve, nga të cilat 30,202 janë

³ Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), HIPC Factsheet (Fletë faktesh për HIPC 2017". Burimi: <http://bit.ly/2n0Vzak>

⁴ The Telegraph, Croatia writes off debts for poorest citizens (Kroacia fshin borxhet e qytetarëve më të varfër). Burimi: <http://bit.ly/1ypyY3T>, qasur më 14 shkurt 2018

⁵ The Washington Post, Croatia just canceled the debts of its poorest citizens (Kroacia sapo anuloi borxhet e qytetarëve më të varfër . Burimi: <http://wapo.st/2DQ8dQZ>, qasur më 14 shkurt 2018

aprovuar, 194 janë duke u përpunuar dhe 4,662 janë refuzuar për mos përmbushje të kriterëve.⁶

Në vitin 2014, Qeveria e Maqedonisë në bashkëpunim me kompani të shërbimeve publike dhe banka ndërmoi iniciativë për shlyerjen e borxheve të qytetarëve të akumuluar deri në fund të vitit 2013, ku synim ishin kryesisht të varfrit, të papunët dhe personat e ve.⁷ Në këmbim për anulimin e borxheve, qeveria u ofroi kompanive pushime tatimore vjetore.⁸ Sipas qeverisë maqedonase, kjo iniciativë kishte ndihmuar 9,000 familje, ani pse aplikimet për përfitimin nga ky program kishin shkuar në mbi 41,000.⁹ Sikurse Kroacia, edhe Maqedonia synoi grupe të caktuara njerëzish që kanë ndjeshmëri më të mëdha financiare për shkak të kushteve në të cilat jetojnë. Ndërkaq, në Kosovë statusi i mirëqenies nuk u konsiderua si kusht, por falja e borxheve u aplikua për të gjithë ata që kanë akumuluar borxhe deri në fund të vitit 2008, me kusht të pagesës së borxheve të akumuluar pas vitit 2008.

Baza ligjore për faljen e borxheve publike

Ligji nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike ka hyrë në fuqi më 3 shtator të vitit 2015 dhe përcakton kriteret dhe procedurat për faljen e borxheve publike ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike. Sipas këtij ligji, nga falja e borxheve publike mund të përfitojnë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, përveç ndërmarrjeve shoqërore nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare për Privatizim (AKP).¹⁰

Falja e borxhit publik të akumuluar deri më 31 dhjetor 2008, në formë të obligimeve tatimore, doganore, tatimit në pronë dhe obligimeve të tjera financiare, përfshin edhe të gjitha obligimet tjera që rrjedhin nga mos pagesa e borxhit bazë (kryegjësë) siç janë interesi, ndëshkimet dhe gjobat.¹¹ Ndërkaq, të gjitha borxhet nën 100 euro do të fshiheshin me automatizëm.¹²

⁶ Qeveria e Republikës së Kroacisë, "107 milionë HRK borxhe të fshira". Burimi: <http://bit.ly/2nW0jPe>, qasur më 12 shkurt 2018

⁷ Reuters: Macedonia's top banks and companies pledge debt write-off for poor. Burimi: <http://reut.rs/2FTXNAz>, qasur më 11 shkurt 2018

⁸ Qeveria e Maqedonisë. "Kampanja e qeverisë fshin 30 milionë euro borxhe të qytetarëve" Burimi: <http://bit.ly/2EYvsss>, qasur më 09 janar 2018

⁹ Qeveria e Maqedonisë. "Gruevski: Programi për anulimin e borxhit ndihmoi 9,000 shtëpi" Burimi: <http://bit.ly/2EWYulZ>, qasur më 09 janar 2018

¹⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-043 për faljen e borxheve publike, neni 2. Burimi: <http://bit.ly/2DxlQSS>

¹¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.05/L-043 për faljen e borxheve publike, neni 3. Burimi: <http://bit.ly/1STtA4k>

¹² Ibid, neni 4.

Nga falja e borxhit publik mund të përfitojnë të gjitha subjektet, përfshirë këtu rastet e paditura, me kusht që të¹³:

- a) paguajnë në tërësi borxhin e akumuluar nga fillimi i vitit 2009 e deri tek fundi i vitit 2014, apo
- b) të nënshkruajnë kontrata të veçanta për t'i paguar borxhet e mbetura me këste brenda periudhës dy vjeçare apo tre vjeçare për persona juridikë dhe fizikë, respektivisht.

Nëse subjektet përmbushin njërën nga dy kriteret e mësipërme, apo nëse nuk kanë borxhe për periudhën deri më 2008, por vendosin të paguajnë borxhet e periudhës 2009-2014 atëherë atyre u falen obligimet për vonesat në pagesën e borxheve siç janë gjobat, ndëshkimet, interesi dhe obligime të tjera, duke paguar kështu vetëm kryegjënë. Por, në rast shkeljeje të marrëveshjes, obligimet do të pasqyrohen sërish në regjistrat kontabël.¹⁴

Fillimisht, subjektet patën mundësi ta shfrytëzojnë faljen e borxheve brenda periudhës një vjeçare nga dita e hyrjes së Ligjit në fuqi, por afati kohor u vazhdua deri më 1 shtator 2017, që do të thotë se ligji ka qenë në fuqi për dy vite.¹⁵

Ligj tjetër i cili rregullon çështjen e borxheve apo detyrimeve të konsumatorëve ndaj institucioneve, është Ligji nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2012. Ky ligj përmban parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve. Por, dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes së Ligjit në fuqi.¹⁶

Prandaj, falja e borxheve në këtë rast trajtohet sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, Ligjit nr. 3/3/1978 mbi marrëdhëniet e detyrimeve.¹⁷ Duke marrë parasysh dispozitat e tij, të vetmet borxhe që mund të ndiqen ligjërisht janë borxhet për të cilat janë ngritur padi brenda afatit ligjor dhe borxhet, afati i parashkrimit të të cilave, ende nuk ka skaduar. Por, sipas këtij ligji, afati mund të jetë sfidë në vete meqë afati për parashkrimin e borxheve të personave fizikë është 12 muaj ndërkaq për persona juridikë është 36 muaj.¹⁸

¹³ Ibid, neni 4.

¹⁴ Ibid, neni 6.

¹⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-043 për faljen e borxheve publike, neni 3. Burimi: <http://bit.ly/2DxlQSS>

¹⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 1057. Burimi: <http://bit.ly/2E51Jhg>

¹⁷ Instituti GAP (2015) "Kush do të përfitojë nga falja e borxheve".

¹⁸ Ibid.

Rezultatet nga ligji për faljen e borxheve

Falja e borxheve për periudhën 2000-2008 përfshin të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët nuk kanë paguar detyrime të ndryshme ndaj institucioneve shtetërore. Edhe pse është arsyetuar si hap për t'ua lehtësuar barrën sidomos kategorisë së varfër, falja e borxheve i ka trajtuar njëjtë rastet sociale me familjet të cilat kanë të hyra më të larta. Konkretisht, për të përfituar nga kjo mundësi, qytetarët është dashur që të paguajnë tërësisht apo të lidhin marrëveshje me institucionin përkatës shtetëror për pagesën e borxhit me këste për periudhën 2009-2014. Marrë parasysh që rreth 17.6% e qytetarëve në Kosovë jetojnë në varfëri, gjasat që ata të përfitojnë nga kjo mundësi kanë qenë të vogla.¹⁹

Nga të gjitha ndërmarrjet publike dhe institucionet shtetërore prej të cilave kemi pranuar të dhëna rreth faljes së borxhit të qytetarëve, borxhi i mbledhur deri në fund të vitit 2008 ishte 584 milionë euro, prej të cilave janë falur rreth 56% (324 milionë euro). Ndërkaq për periudhën 2009-2014, nga borxhi total 254 milionë euro janë shlyer 30% (76 milionë euro).


Qytetarët përfitues nga falja e borxheve

Krahas analizimit të të dhënave rreth faljes së borxheve nga përgjigjet e pranuar nga institucionet publike, Instituti GAP ka kryer dhe një hulumtim në 38 komuna të Kosovës për të matur vlerësimet e qytetarëve rreth faljes së borxheve.

Sipas hulumtimit të Institutit GAP, Ligji për faljen e borxheve është pritur mjaft mirë nga qytetarët. Mbi 77% e të anketuarve e kanë vlerësuar faljen e borxheve si të drejtë, ndërsa 8% e kanë cilësuar atë si të padrejtë. Nga ata që nuk janë pajtuar me këtë ligj (8%), mbi 82% nuk kanë përfituar nga falja e borxheve. Kjo na lë të kuptojmë se konsumatorët që kanë paguar faturat me rregull janë dekurajuar nga kjo iniciativë.

¹⁹ Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012 – 2015. Prill 2017. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <http://bit.ly/2I38Uk0>


FIGURA 1: LIGJI PËR FALJEN E BORXHEVE TË QYTETARËVE, KA QENË:



Burimi: Instituti GAP

Mirëpo, sipas të gjeturave nga ky hulumtim, jo të gjithë qytetarët e kanë shfrytëzuar mundësinë që të përfitojnë nga falja e borxheve. Të dhënat e mbledhura tregojnë se vetëm 43% e të anketuarve kanë përfituar nga ky rast. Për më shumë, vetëm 52% nga të anketuarit që vendimin e kanë cilësuar si të drejtë kanë përfituar nga falja e borxheve.

FIGURA 2: A KENI PËRFITUAR JU NGA VENDIMI PËR FALJEN E BORXHEVE?



Burimi: Instituti GAP

Ndërsa, nëse analizojmë përfituesit në bazë të të hyrave të familjeve të tyre, vërejmë që më shumë kanë përfituar respondentët më të hyra mujore të larta se sa ata me më pak të hyra. Specifikisht, gjetjet tregojnë se 50% e respondentëve që së bashku me familjen kanë të ardhura mujore mbi 900 euro kanë përfituar nga Ligji për faljen e borxheve, ndërsa vetëm 38% e respondentëve që nuk realizojnë të ardhura mujore si familje dhe 49% e atyre që kanë të ardhura mujore deri në 150 euro kanë përfituar nga kjo mundësi. Përveç mos interesimit të vetë qytetarëve për të përfituar nga ligji në fjalë, shkaqe për këtë dallim mes këtyre kategorive mund të jenë dhe mungesa e

një trajtimit të veçantë për qytetarët më të hyrat të ulëta dhe mos targetimi nga qeveria i grupeve të rrezikuara nga varfëria në kampanjat senzibilizuese.

TABELA 1: PËRFITUESIT E FALJES SË BORXHEVE SIPAS TË ARDHURAVE MUJORE TË FAMILJES

Të ardhurat personale	Përfitur nga falja e borxheve?	
	Po	Jo
0 - 150 euro	49%	51%
151 - 300 euro	47%	53%
301 - 450 euro	39%	61%
451 - 600 euro	56%	44%
601 - 750 euro	57%	43%
751 - 900 euro	64%	36%
Mbi 900 euro	50%	50%
Nuk kam realizuar fare të ardhura	38%	63%
Refuzon të përgjigjet	22%	78%


Burimi: Instituti GAP

Shlyerja e borxheve ndaj institucioneve shtetërore

Sipas raportit të fundit të Komisionit për Faljen e Borxheve (2017)²⁰, shuma e evidentuar për falje për periudhën 2000-2008 nga ndërmarrjet publike, komunat, ATK dhe Dogana është rreth 568 milionë euro. Kjo shumë e evidentuar nga komisioni dallon nga ajo e prezantuar nga ish-ministri i Financave Avdullah Hoti në Kuvendin e Kosovës në vitin 2015 (rreth 680 milionë euro).²¹ Ky dallim është për shkak që raporti i komisionit nuk evidenton borxhet e të gjitha ndërmarrjeve publike. Borxhin më të madh, qytetarët në këtë periudhë e kanë pasur ndaj ATK (48%) dhe më pas ndaj ndërmarrjeve publike, ku afro 70% e këtij borxhi ishte ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).

²⁰ Raport lidhur me faljen e borxheve. Ministria e Financave, Komisioni për Faljen e Borxheve. Përgjigje me e-mail, 30 nëntor 2017.

²¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Transkript i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 9 dhe 10 korrik 2015. Burimi: <http://bit.ly/2DXhiL9>

FIGURA 3: BORXHI PËR T'U FALUR PËR PERIUDHËN 2000-2008 SIPAS INSTITUCIONEVE

Burimi: Instituti GAP

Borxhet ndaj ndërmarrjeve publike

Nga të dhënat që kemi pranuar për ndërmarrjet publike, KEK-u ka falur shumën më të madhe të borxhit për periudhën 2000-2008. Nga gjithsej 262 milionë euro borxhe, janë falur rreth 111 milionë euro (42%). Po ashtu, KEK-u ka shlyer rreth 25 milionë euro borxhe të qytetarëve për periudhën 2009-2014.

Kurse, në bazë të përgjigjeve të zyrtarëve të Termokosit, detyrimet e falura të qytetarëve që i takojnë periudhës 2000-2008 ishin 4.6 milionë euro. Rreth 4.5 milionë euro u janë falur amvisërive (96%) dhe 185 mijë euro bizneseve dhe kategorive tjera (4%).

Nga kompanitë rajonale të ujësjellësit prej të cilave kemi pranuar të dhëna, KRU "Hidroregjioni Jugor" nga Prizreni prin me shumën e falur për periudhën 2000-2008; afro 2.5 milionë euro nga gjithsej 3.7 milionë euro borxhe. Përfituesit e vetëm nga falja e borxhit nga ky institucion kanë qenë personat fizikë (amvisëritë). Nga borxhet ndaj KRU "Bifurkacioni", që mbulon Ferizajn dhe Kaçanikun, 15% e përfituesve kanë qenë biznese të mëdha (131 mijë euro) dhe 85% kanë qenë persona fizikë (753 mijë euro).

Kurse, të dhënat e pranuar rreth faljes së borxheve nga kompanitë rajonale të mbeturinave (KRM), tregojnë se KRM "Pastërtia" nga Ferizaj ka falur borxhin më të madh të periudhës 2000-2008 (rreth 479 mijë euro). Afro 84% e borxhit të falur u ka takuar amvisërive (402 mijë euro), 14% bizneseve të mëdha (69 mijë euro) dhe 2% bizneseve të vogla (8,600 euro). Për dallim, nga shlyerja e borxheve nga KRM "Çabrati", kategoria e dytë më e madhe e përfituesve pas amvisërive (87%) kanë qenë bizneset e mëdha (12%).

FIGURA 4: BORXHI I SHLYER SIPAS KATEGORIVE DHE NDËRMARRJEVE PUBLIKE PËRKATËSE



Burimi: Instituti GAP

Siç u përmend edhe më lartë, kusht për të përfituar nga falja e borxheve për periudhën 2000-2008 ka qenë shlyerja e borxheve (bazës) për periudhën 2009-2014. Me këtë rast, qytetarët kanë përfituar edhe nga shlyerja e ndëshkimit, interesit dhe gjobës për periudhën 2009-2014. Nga të dhënat e detajuara nga tri ndërmarrje publike, vërejmë se për vitet 2009-2014, KRU "Hidroregjioni Jugor" ka shlyer si borxh të qytetarëve rreth 3.2 milionë euro, KRU "Radoniqi" rreth 1.9 milionë euro dhe KRM "Çabrati" rreth 3.3 milionë euro (shih Aneks 1). Në përgjithësi, amvisëritë (individët) prijnë qoftë në shumën e pa shlyer ndaj institucioneve por edhe si përfituesit më të mëdhenj nga falja e borxheve.

Borxhet ndaj ATK-së dhe Doganës

Nga institucionet shtetërore, ATK është institucioni ndaj të cilit qytetarët dhe bizneset kanë pasur më së shumti borxh të pa shlyer për periudhën 2000-2008. Nga afro 291.6 milionë euro borxh ndaj saj, tatimpaguesve u janë falur rreth 201.5 milionë euro (69%). Ndërsa për periudhën 2009-2014 tatimpaguesve u janë shlyer rreth 44 milionë euro. Kjo shumë paraqet rreth 32% të borxhit total të tyre ndaj ATK (137 milionë euro) për periudhën 2009-2014.


Ndërsa, Dogana e Kosovës nga 6 milionë euro borxhe që kishin qytetarët ndaj saj për periudhën 2000-2008, ka falur rreth 586 mijë euro. Për periudhën 2009-2014, Dogana ka shlyer si borxh të qytetarëve rreth 268 mijë euro.

Ndikimi i ligjit në arkëtim në vitet 2015 dhe 2016

Si arsye kryesore për iniciativën për faljen e borxheve ndaj institucioneve shtetërore ka qenë që të ndihmohen qytetarët në aspektin financiar, duke ua lehtësuar barrën e borxheve. Njëkohësisht, është menduar që të njëjtit të nxiten që të jenë më të rregullt në kryerjen e detyrimeve ndaj institucioneve në fjalë për vitet pasuese. Nga ana e institucioneve relevante, Ligji për faljen e borxheve ka synuar që t'i nxisë ato për t'i evidentuar të gjitha borxhet e qytetarëve dhe që t'i administrojnë më mirë ato në vijim.

Meqë Ligji për faljen e borxheve ka hyrë në fuqi në vitin 2015, një ndikim pozitiv i tij tek sjellja e qytetarëve karshi detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore do të duhej të ishte më evident në vitin 2016. Në 2016, siç vërehet në grafikonin e mëposhtëm, një rënie më të theksuar të borxhit të qytetarëve dhe bizneseve kishte ndaj KRM “Çabratit” në Gjakovë (83%) dhe KRM “Pastërtia” në Ferizaj (61%). Ndërsa, rritje të borxhit të qytetarëve dhe bizneseve në 2016, për dallim nga 2015, kishte ndaj Termokosit në Prishtinë (21%) dhe KRM “Bifurkacioni” (7%) në Ferizaj.

FIGURA 5: BORXHET E QYTETARËVE DHE BIZNESEVE NDAJ INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË 2015 DHE 2016




Burimi: Instituti GAP

Kurse, nga analizimi i performancës së sektorit të shërbimeve të ujit bazuar në shkallën e arkëtimit, në 2016 vërehet një performancë dukshëm më e mirë e këtij sektori në krahasim me vitet paraprake. Specifikisht, shkalla e arkëtimit nga i tërë sektori në 2016 është rritur për 12 pikë përqindje në krahasim me 2015 dhe 15 pikë përqindje në krahasim me 2013. Ndryshim më signifikant në arkëtim përgjatë viteve vërehet në rastin e KRU “Prishtina”, KRU “Bifurkacioni” dhe KRU “Hidroregjioni Jugor”. Për dallim nga 2015, në 2016, të njëjtat kanë rritur shkallën e arkëtimit me 16, 16 dhe 13 pikë

përqindje, respektivisht. Po ashtu, performancë më të mirë se në vitet e kalura, përgjatë 2016, kanë pasur dhe kompanitë tjera të ujësjellësit. Siç vërehet në figurën më poshtë, thuajse të gjitha KRU-të kanë pasur rritje të vazhdueshme në shkallën e arkëtimit nga 2013. Mirëpo, dallimi në arkëtim në 2016 ishte edhe më i madh, që mund të jetë si rezultat i ndikimit të ligjit për faljen e borxheve.

FIGURA 6: SHKALLA E ARKËTIMIT (%) NGA KRU-TË, 2013-2016



Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhënat e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit

Andaj, një nga aspektet me rëndësi rreth kësaj teme mbetet efekti i arritur i Ligjit për faljen e borxheve. Nga perspektiva e institucioneve prej të cilave kemi pranuar të dhëna rreth faljes së borxheve (12), që të gjitha kanë vlerësuar se ligji në fjalë e ka arritur qëllimin vetëm pjesërisht. Nga arsyet kryesore për këtë, institucionet kanë përmendur gjendjen e dobët ekonomike të qytetarëve dhe mungesën e efikasitetit të gjyqësorit. Meqë për të përfituar nga falja e borxheve është dashur që të kryhen pagesa për periudhën 2009-2014, qytetarët, sipas vetë institucioneve, kanë hequr dorë nga shfrytëzimi i kësaj mundësie. Ndërkaq, arsyeja e dytë ka të bëjë me mos trajtimin e lëndëve të dërguara në gjykatë nga këto institucione shtetërore. Specifikisht, si rrjedhojë e mungesës së dënimeve të shumta nga gjykatat për qytetarët të cilët nuk kanë kryer obligimet në fjalë, qytetarët nuk kanë pasur shtytje që të aplikojnë për faljen e borxheve; gjë që kërkonte edhe pagesën e një pjese të borxhit.

Përfundime dhe rekomandime

Sipas të gjeturave të Instituti GAP, nga të gjitha ndërmarrjet publike dhe institucionet shtetërore prej të cilave kemi pranuar të dhëna rreth faljes së borxhit të qytetarëve, borxhi i mbledhur deri në fund të vitit 2008 ishte 584 milionë euro, prej të cilave janë falur rreth 56% (324 milionë euro). Ndërkaq për periudhën 2009-2014, janë shlyer 76 milionë (30%) nga 254 milionë euro borxh i identifikuar nga Instituti GAP. Duke marrur parasysh këto të gjetura, Ligji për faljen e borxheve ka arritur vetëm pjesërisht qëllimin për faljen dhe shlyerjen e borxheve të qytetarëve dhe bizneseve.

Megjithatë, ky ligj doli të jetë iniciativë e mirë për të parë gjendjen e detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike si dhe për të vlerësuar kapacitetet e tyre në mbledhjen e borxhit nga konsumatorët. Kjo mundësoi krijimin e listave të borxhlinjve si dhe llogaritjen e borxhit total të akumuluar. Gjithashtu, ky ligj lehtësoi barrën e disa konsumatorëve që e panë të arsyeshme shfrytëzimin e tij.

Edhe pse në këtë fazë është vështirë të konkludohet nëse ky ligj stimuloi konsumatorët të ndryshojnë sjelljen kundrejt detyrimeve të tyre për vitet 2015 dhe 2016, duke u bazuar vetëm në sektorin e shërbimeve të ujit, shihet një rritje në shkallën e arkëtimit nga këto ndërmarrje publike.

Prandaj, për të përmirësuar transparencën dhe mbledhjen e detyrimeve nga institucionet publike dhe rritur përgjegjësinë e konsumatorëve, Instituti GAP rekomandon:

- Ministria e Financave t'i publikojë të dhënat e detajuara për procesin e faljes së borxheve. Të dhënat të paraqiten të ndara në bazë të institucioneve dhe në bazë të kategorive të përfituesve (qytetarë, biznese, institucione);
- Zyra Kombëtare e Auditimit të bëjë auditimin e rregullsisë për procesin e faljes dhe shlyerjes së borxheve, meqenëse ky proces ka qenë mjaft i mbyllur dhe raportimi nga organe të ndryshme, institucionet apo ndërmarrjet publike nuk është i njëjtë me atë të komisionit për faljen e borxheve pranë Ministrisë së Financave;
- Qeveria e Kosovës të falë me automatizëm borxhet që kanë familjet nën skemën e asistencës sociale ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike. Gjithashtu në të ardhmen, të hartojë programe të veçanta për çështjen e borxheve të këtyre familjeve ndaj institucioneve;


Për institucionet dhe ndërmarrjet publike:

- Të përdorin përmbauesit privat në mënyrë që të jenë më efektiv në mbledhjen e borxheve brenda afateve ligjore;

- Të ofrojnë alternativave për pagesën e detyrimeve, si për shembull të krijohen marrëveshje përmes së cilave përcaktohet ndalesa automatike e një përqindjeje të rrogës nga llogaria e konsumatorit;
- Të ofrojnë mundësi që pagesat të kryhen përmes e-banking apo online;
- Të përdorin softuer për identifikimin e konsumatorëve më likuidë, konsumatorëve me rrezik më të madh për mos pagesë dhe borxhlinjëve më të mëdhenj.

ANEKS

ANEKS 1: BORXHI I SHLYER NGA KRU-TË DHE KRM SIPAS KATEGORIVE, 2009-2014



ANEKS 2: SHUMA E BORXHEVE DERI MË 31 DHJETOR 2008

Institucioni	Amvisëri	Biznese të vogla	Biznese të mëdha	Institucionet	Tjera	Gjithsej
KEK						262,000,000.00 €
Termokos	9,466,499.02 €		2,119,555.18 €			11,586,054.20 €
Dogana						6,017,604.00 €
ATK						291,631,945.16 €
N.P.H Ibër-Lepenc					38,128.64 €	38,128.64 €
KMDP sh.a.		6,837.16 €	668,585.31 €			675,422.47 €
KRM "Ambienti" sh.a.	200,000.00 €	130,000.00 €	70,000.00 €	0.00 €	0.00 €	400,000.00 €
KRU "Radoniqi" sh.a.	3,956,420.86 €		1,060,149.08 €		0.00 €	5,016,569.94 €
KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a.	3,505,489.22 €		150,235.25 €			3,655,724.47 €
KRM "Çabrati" sh.a.	679,116.26 €	146,884.89 €	191,246.24 €			1,017,247.39 €
KRM "Pastërtia" sh.a.	1,316,995.04 €	88,909.21 €	648,713.89 €	137,053.89 €	0.00 €	2,191,672.03 €
KRU "Bifurkacioni"	2,155,047.26	258,361.36	109,332.48	254,050.19		2,776,791.29

ANEKS 3: SHUMA E BORXHEVE NGA 1 JANARI 2009 DERI ME 31 DHJETOR 2014

Institucioni	Amvisëri	Biznese të vogla	Biznese të mëdha	Institucionet	Tjera	Gjithsej
KEK						96,000,000.00 €
Termokos	6,005,510.74 €				911,322.92 €	6,916,833.66 €
Dogana						585,607.00 €
ATK						135,776,060.42 €
N.P.H Ibër-Lepenc					179,545.15 €	179,545.15 €
KMDP sh.a.		6,608.57 €	1,192,678.50 €			1,199,287.07 €
KRM "Ambienti" sh.a.	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
KRU "Radoniqi" sh.a.	4,461,182.78 €		189,625.94 €		0.00 €	4,650,808.72 €
KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a.	5,805,368.88 €		1,451,342.22 €			7,256,711.10 €
KRM "Çabrat" sh.a.	1,264,529.35 €	316,778.92 €	99,112.70 €			1,680,420.97 €
KRM "Pastërtia" sh.a.						0.00 €
KRU "Bifurkacioni"	2,666,136.76	295,566.92	152,460.28	298,422.19		3,412,586.15

ANEKS 4: SHUMA E BORXHEVE TË SHLYERA QË I TAKOJNË PERIUDHËS DERI MË 31 DHJETOR 2008

Institucioni	Amvisëri	Biznese të vogla	Biznese të mëdha	Institucionet	Tjera	Gjithsej
KEK						111,000,000.00 €
Termokos	4,449,811.29 €				185,102.54 €	4,634,913.83 €
Dogana	149,293.27 €	3,675,591.94 €				3,824,885.21 €
ATK						201,489,712.20 €
N.P.H Ibër-Lepenc					30,873.24 €	30,873.24 €
KMDP sh.a.		2,072.34 €				2,072.34 €
KRM "Ambienti" sh.a.	85,000.00 €	75,000.00 €	35,000.00 €	0.00 €	0.00 €	195,000.00 €
KRU "Radoniqi" sh.a.						0.00 €
KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a.	2,509,287.93 €					2,509,287.93 €
KRM "Çabrat" sh.a.	199,662.41 €	29,410.77 €		1,581.04 €		230,654.22 €
KRM "Pastërtia" sh.a.	402,499.52 €	8,601.00 €	69,135.36 €	0.00 €	0.00 €	480,235.88 €
KRU "Bifurkacioni"	752,938.90		135,151.70			888,090.60

ANEKS 5: SHUMA E BORXHEVE TË SHLYERA QË I TAKOJNË PERIUdhËS 1 JANAR 2009 - 31 DHJETOR 2014

Institucioni	Amvisëri	Biznese të vogla	Biznese të mëdha	Institucionet	Tjera	Gjithsej
KEK						8,000,000.00 €
Termokos	0.00 €	0.00 €				0.00 €
Dogana						0.00 €
ATK						43,588,908.65 €
N.P.H Ibër-Lepenc					73,077.88 €	73,077.88 €
KMDP sh.a.		0.00 €				0.00 €
KRM "Ambienti" sh.a.	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
KRU "Radoniqi" sh.a.	420,051.45 €					420,051.45 €
KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a.	/	/				0.00 €
KRM "Çabрати" sh.a.	1,264,529.35 €	316,778.92 €	99,112.70 €			1,680,420.97 €
KRM "Pastërtia" sh.a.						0.00 €
KRU "Bifurkacioni"						0.00 €

ANEKS 6: SHUMA E BORXHEVE TË SHLYERA ME KËSTE QË I TAKOJNË PERIUdhËS 1 JANAR 2009-31 DHJETOR 2014

Institucioni	Amvisëri	Biznese të vogla	Biznese të mëdha	Institucionet	Tjera	Gjithsej
KEK						8,000,000.00 €
Termokos	0.00 €			0.00 €		0.00 €
Dogana						0.00 €
ATK						0.00 €
N.P.H Ibër-Lepenc					0.00 €	0.00 €
KMDP sh.a.						0.00 €
KRM "Ambienti" sh.a.	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
KRU "Radoniqi" sh.a.	1,429,686.64 €			84,345.99 €		1,514,032.63 €
KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a.	752,990.89 €					752,990.89 €
KRM "Çabрати" sh.a.	45,564.26 €	8,767.31 €	1,442.66 €		0.00 €	55,924.91 €
KRM "Pastërtia" sh.a.						0.00 €
KRU "Bifurkacioni"						0.00 €

**ANEKS 7: SHUMA E BORXHEVE TË KONTRAKTUARA PËR SHLYERJE QË I TAKOJNË PERIUDHËS 1
JANAR 2009 - 31 DHJETOR 2014**

Institucioni	Amvisëri	Biznese të vogla	Biznese të mëdha	Institucionet	Tjera	Gjithsej
KEK						9,000,000.00 €
Termokos	0.00 €				0.00 €	0.00 €
Dogana						267,802.31 €
ATK						0.00 €
N.P.H Ibër-Lepenc					1,778.70 €	1,778.70 €
KMDP sh.a.						0.00 €
KRM "Ambienti" sh.a.	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
KRU "Radoniqi" sh.a.						0.00 €
KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a.	2,522,676.33 €					2,522,676.33 €
KRM "Çabrati" sh.a.	171,409.52 €	41,728.37 €		2,299.05 €	0.00 €	216,960.56 €
KRM "Pastërtia" sh.a.						0.00 €
KRU "Bifurkacioni"						0.00 €

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:

